Përgatitja: në mikser hidhni qumështin e kokosit, manaferrat, anansin, mangon, hurmat e arabisë dhe acai berry pluhur, përzieni mirë, pastaj kalojeni smoothin në një gjysëm arrë kokosi ose në një enë qelqi. Për granolat miksoni hikrrën, bajamet, kasjusin, farat e susamit, farat kia dhe arrën e kokosit së bashku pastaj përhapini në letër pjekje në furrë në 170°C, në një tas shkrini gjalpin e kokosit dhe mjaltin, shtoni ekstraktin e vaniljes dhe kafen, largojeni nga zjarri dhe hidheni përzierjen mbi miksin e pjekur, përhapeni mirë dhe spërkateni me kripë. Piqeni edhe për 25-30 minuta të tjera, përzieni 1-2 herë gjatë pjekjes. Granola është gati kur hikrra të marrë ngjyrë kafe të artë. Lëreni granolën të ftohet plotësisht para se ta coptoni dhe ta fusni në smoothin e ftohur. Në siperfaqe i shtoni përbërës për dekor.

Supë me Qiqra

Përbërësit:
2 lugë vaj ulliri Nutria
2 lugë gjalpë i pakripur Gioia
1 qepë e ëmbël, e prerë
2 thelbinj hudhër, të grirë
1 majë fara spec Bukove
4 gota kubik kungulli të verdhë
1/2 lugë çaji kripë Himalaje
1/2 lugë çaji piper Kubeba
1/4 lugë çaji piper i kuq i tymosur
1/8 lugë çaji arrë Indi pluhur
2 gota lëng pulle ose perimesh
170 gr djathë i tymosur Gruyere
1/2 filxhan qumështi kokosi, plus shtesë për zbukurim
2 lugë gjelle qepë e njomë (chives)
Qiqra pikante:
2 gota qiqra (nëse janë të konservuara, kullojini dhe lërini të thahen
1/2 lugë gjelle vaj ulliri
1/4 lugë çaji kripë Hawaiane
1/4 lugë çaji piper Jeshil
1/4 lugë çaji piper i kuq i tymosur
1/4 lugë çaji piper i kuq
Përgatitja: piqni qiqrrat e marinuara me erëzat dhe vajin e ullirit në furrë, në 200 °C për rreth 20 minuta, tundeni tepsinë dhe piqini edhe për rreth 20 minuta të tjera. Në një tenxhere të madhe shtoni vajin e ullirit dhe gjalpin, shtoni qepën me farat e specit dhe një majë luge kripë, përzieni, skuqini deri sa të zbuten, për rreth 5 minuta. Shtoni hudhrën dhe skuqeni për një minutë. Përzieni kungullin, kripën, piperin, specin e kuq dhe arrën e indit. Mbulojeni tenxheren dhe gatuajeni kungullin derisa të jetë zbutur pak, 6 deri në 8 minuta, përzieni herë pas here. Shtoni lëngun e pulës dhe vendoseni përzierjen në zierje. Zjejini derisa kungulli të jetë zbutur plotësisht. Pasi përzierja të jetë zier kalojeni në mikser dhe përziejeni derisa të bëhet një krem homogjen. Hidheni supën përsëri në tenxhere dhe vendoseni në zjarr të mesëm-të ulët. Shtoni djathin, lëreni derisa të shkrihet, shtoni qumështin e kokosit dhe vendoseni sërisht në zierje për disa minuta. Në momentin e servirjes shtoni qiqrrat pak qumësht kokosi dhe qepët e njoma.

Përbërësit i gjeni tek dyqanet e rrjetit Neranxi.

Qiqrat

Përmbajtja e lartë në fibra ndihmonë në uljen e kileve të tepërta, pasi mbajnë për një kohë të gjatë ndjenjën e ngopjes. Nëse konsumoni rregullisht qiqra, keni shanset për të ulur kilet e tepërta. Përmbajnë sasi të lartë proteinash dhe mineralesh, shtojnë energjinë dhe forcojnë metabolizmin



Shishqebab Salmoni me Erëza

Farat e Kuminit

Rrisin sekretimin e qumështit, pastrojnë zorrët, janë të mira për gastritin, për inflamacionin e zorrëve, fryrjet, kapsllëkun. Farat e kuminit janë cilësuar si një nga produktet më të efektshme i cili ndihmon në rënien në peshë në mënyrë të shpejtë dhe të natyrshëme.

Përbërësit për 4 persona:

700 gr fileto salmoni pa lëkurë (mundësisht egër), të prerë në kubik
2 lugë gjelle rigon
2 lugë çaji fara susami
1 lugë çaji fara kumini
1 lugë çaji kripë Himalaje
¼ lugë çaji farë speci Bukove
2 kokërr limon, i prerë në feta të holla
2 lugë gjelle vaj ulliri
16 shkopinj bambuje të njomur në ujë për rreth 1 orë.

Përgatitja:
Vendosni në ngrohje grillën.
Miksoni rigonin, farat e susamit, farat e kuminit, kripën dhe farat e specit në një tas, marinoni salmonin dhe vendosini në shkopinj së bashku me fetat e limonit dhe vendosini në skarë, duke i kthyer herë pas here, piqini derisa salmoni të ketë marrë ngjyrë, rreth 5-8 minuta.

Përbërësit i gjeni tek dyqanet e rrjetit Neranxi.

NERANXI 1991

USHQIMET
Produkte e Reja
tek Dyqanet Neranxi

KAPSULAT MEDI GRUN, REVOLUCIONI I MJEKËSISË BIMORE

Të shërohesh, të humbash peshë apo të rifitosh energji të reja, tashmë është e mundur me kapsulat gjermane 100% bimore!

Kompania "MediGrün Naturprodukte GmbH" prodhon një gamë të produkteve superiore organike, lëngje natyrore dhe shtojca dietike në standardet më të larta gjermane. Nga analizat eshte provuar se jo domosdoshmërisht produktet e shtrenjta janë ato që konfirmojnë cilësinë, por ata që mbështeten në fuqinë e natyrës, si produkte MediGrün. Produktet duke përdorur natyrën si farmacinë më të madhe në botë janë ato që kanë kënaqur klientët duke zgjeruar numrin e tyre. Interesi në shëndetin e klientëve tanë rritet nga viti në vit, ndaj dhe kompania jonë ka sjellë produkte të reja për tregun botëror.

Kjo thekson dhe fuqinë e natyrës, duke punuar me kompani analitike dhe të njohura në drejtim të teknologjisë ushqimore me mjekët dhe nutritionistës të cilët rekomandojnë produktet tona në klinikat e specializuara. www.lefo.de është Instituti i Kontrollit të Cilësisë së Ushqimit, i pavarur dhe i akreditуar nga Ministria e Shëndetësisë së Gjermanisë, i cili vërteton certifikimin e produkteve MediGrün për shitje dhe tregëtim. MediGrün është kompani e certifikuar për produkte organike dhe ka licensën OPC të kongresit, për shpërndarjen, importit dhe eksportit, e miratuar për të gjitha shtetet me networkun e tyre.

Kompania Neranxi ka ekskluzivitetin e Produkteve të Kompanisë Gjermane Medi Grün për Shqipërinë dhe Kosovën.

MOMORDICA kompleks (60 kapsula) - Parandalo Diabeti -Mbron nga Kanceri -Antispasmatike - Rinovon Qelizat - Kuron Psoriasisin - Përmirëson Tretjen

Mormodica është përdorur në mjekësinë tradicionale për trajtimin e diabetit duke ulur nivelet e sheqerit në gjak, kancerit sidomos atij te gjirit, melcise, prostates, zorres se trashe dhe kancerit ne gjak(leucemise), çrregullimeve të zorrëve, është antispasmatik, analgjezik, qetësues dhe ka efektë tonifikues për trupin, përmirëson qarkullimin e gjakut, stimulon rinovimin e qelizave, lufton lodhjen (fizike dhe mendore), lufton dhimbjet e forta te kokes dhe rrit energjinë. Gjatë viteve shkencëtarët kanë vërtetuar shumë nga përdorimet tradicionale të kësaj bime te hidhur (Momordica charantia) që vazhdon të jetë një zgjidhje e rëndësishme natyrore në sistemet e mjekësisë bimore. kapsulat momodica janë duke u bërë më gjerësisht te perdorura në Shtetet e Bashkuara dhe Europe për diabet, viruset, ftohjet dhe gripit, kancerit dhe tumoreve, kolesterolit të lartë, dhe psoriasis. fruta dhe ekstrakti i farave të koncentruar gjenden në kapsula si keto qe keni ne duar. Përbërësit: Extrakt Momordica Charantia, Extrakt i gjetheve të Gynema Sylvestre (fruti i mrekullise), Garcinia cambogia, pluhur frutash, ekstrakt boronice, mana të zi, mbushës: celulozë Micro Krista, agjent qetësues: kripëra magnezi të acideve yndyrore. Materiali i kapsulave: xhelatinë e fortë. Përdorimi: 2 kapsula në ditë

RASPBERRY KETONE - Ketone Mjedre (60 kapsula) Shkrijnë Dhjamin e Barkut - Djegin Yndyrën në gjithë trupin - Presin Oreksin - Rrisin Energjinë e Trupit

Ketonet e Mjedrës është një shtesë unike natyrore dietetike. Ketonet kanë një strukturë molekulare të ngjashme me molekulat e njohura si capsaicina dhe sinefrina. Kjo familje molekulash ndihmon në rritjen e metabolizmit. Kur metabolizmi rritet, trupi djeg më shumë yndyrë duke promovuar rënien në peshë. Sipas disa studimeve, ketonet janë çelësi i cilësisë i cili mbron kundër shtimit në peshë dhe yndyrnave të pashëndetshme në mëlçi. Ketonet e Mjedrës janë miksi i fuqishëm i superfrutave dhe anti-oksidantëve, pa mbushës, lidhës dhe përbërës artificial. Ky miks natyral gjithashtu përmban çaji jeshil, i pasur me antioksidantë e cila mbron trupin nga radikalet e lira, stresi dhe dëmtimet. Ketonet e Mjedrës shkrijnë dhjamin e barkut, djegin yndyrën në gjithë trupin, presin oreksin, rrisin energjinë e trupit. Përbërësit: ketone mjedre, uthull molle pluhur, grejpfrut pluhur, Acai pluhur, Guarana, çaji jeshil, niseshte tapioke, stearatë magnezi. Përdorimi: 2 kapsula në ditë.

100% ACEROLA ORGANIKE PLUHUR (60 kapsula) Parandalo Diabetin - Mbron Zemrën - Parandalon Rrudhat - Parandalon Kancerin - Ekuilibron Hormonet

E njohur si Acerola, emri latin. (Malpighia glabra), është "qershi e Barbadosit", pemë amtare në Amerikën Qendrore dhe tani e kultivuar kryesisht në Brazil.Acerola është e pasur në vitaminë C (Mesatarisht 100 g Acerola të pjekura përmbajnë 1700 mg C), dhe gjithashtu përmban vitamina A, thiaminë, riboflavin, niacin. Njerëzit e kanë përdorur atë në mjekësinë tradicionale.Acerola përdoret për të trajtuar ose parandaluar ekzemën, një sëmundje të shkaktuar nga mungesa e vitaminës C. Acerola është përdorur edhe për parandalimin e sëmundjeve të zemrës, "forcimin e arterieve" (arteriosklerozë), mpiksjes së gjakut dhe kancerit.Acerola përdoret për të trajtuar ftohjen, gjakderdhjen në sy (hemorragji retinale), prishjen e dhëmbëve, infeksionet ngjitëse, depresionin, alergjitë dhe çrregullimet e kolagjenit.Atletët e përdorin Acerolën për përmirësimin e forcës fizike.
Përbërësit: pluhur i frutave Acerola ekstrakt me 17% vitaminë C natyrale. Përdorimi: 1kapsulë në ditë.

MUMIJO-Shilajit 200mg (30 kapsula) Rrit Aktivitetin Seksual- Rrit Potencën Mashkullore - Trajton Infertilitetin - Qetëson Menopauzën - Kuron Aneminë

Mumijo është i vjetër 2000 vjet në mjekësinë aziatike, Ruse, Perse, Kineze, dhe Tibetiane. Ai është formuar me anë të aktivitetit të pllakave tektonike të tokës një 'lëng mali' i florës së Azisë qëndrore. Mumijo arrin të piqet pas 20 viteve të bimëve të balsamosura dhe është substanca origjinale, e më shumë se 80 mikro dhe makro elementëve të ndryshëm dhe përmban më shumë se 10 amino-acide. Rekomandohet për: Rigjenerimin e kockave, sidomos pas thyerjeve. Kundër inflamacionit: bajamet, sinuset dhe bronkit.Trajton osteoporozën. Forcon sistemin imunitar. Normalizon potencën, rrit aktivitetin seksual, trajton infertilitetin dhe problemet e menopaizes tek femrat.Trajton ulçerat e stomakut dhe traktin e zorrëve.Trajton infeksionet e forta urogjenitale.Alergjitë,hemorroidet,dhe përmirëson qarkullimin e gjakut. Përmban shumë minerale për trajtimin e anemisë. Përdoret nga atletët që praktikojnë sportet ekstreme: maratonë,Triathlon, çiklizëm, etj. Shilajit eshte i zi dhe ngjitës, i larë me ujrat pranverore derisa pastrohet nga të gjitha mbetjet ranore dhe ajo që mbetet është molekule e pastër Shilajit. Nga 100 kg Shilajit lëndë e papërpunuar, në fund të procesit të pastrimit mbetet vetëm 10% Shilajit i pastër bioaktiv.Vetëm substanca origjinale e shilajitit gjendet në kaspulat që ne ofrojmë. Përmban: pluhur mumijo-shilajit 200 mg, Kopleks acidi fulvik,Vitaminë B1 0- 5 mg,Vitamina B2-0.5 mg, Vitamina B6- 0.5 mg,Vitamina B9- 70 mcg ,Vitamina B12- 1mcg,Vitamina C -25 mg. Materiali i kapsulave: xhelatinë e fortë.
Përdorimi: 4 kapsula në ditë, trajtim për 30 ditë, ndërpriteni 10 ditë dhe rifillojeni sërisht trajtimin për 30 ditë. Bëni të paktën 2 cikle në vit.

GELENK ACTIVE - ARTIKULACIONE AKTIVE (60 kapsula) - Forcon Flokët dhe Thonjtë - Përmirëson gjendjen e Lëkurës - Heq rrudhat - Lufton Aartritin Remautoid

Kolagjeni i hidrolizuar është një proteinë e lidhur me vitaminën E, duke ushqyer dhe gjallëruar qarkullimin.Vitamina E mbron qelizat nga radikalet e lira dhe është një antioksidant i fuqishëm. Kolagjeni-(shtesë ushqimore), i cili rindërton indet, i cili lejon qarkullimin e toksinave dhe yndyrnave, duke i eleminuar ato, dhe ka efekt në ushqyerjen dhe hidratimin e qelizave. Efektet e kolagjenit përmirësojnë kushtet dhe cilësinë e lëkurës, pastron lëkurën nga puçrat dhe e rigjeneron atë, gjithashtu redukton shfaqjen e rrudhave. Artriti reumatid: eliminon dhimbjet në nyje dhe rigjeneron indet. Rrit potencën seksuale, rigjeneron prostate, i bën enët e gjakut më fleksibël, largon mbetjet e yndyrnave në organet e brëndshme (mëlçi, zemrër, zorrë, etj), është e rekomanduar për shërim pas një operacioni - përmirëson gjendjen e flokëve dhe thonjve, forcon zemrën - redukton celulitin. Mbron enët e gjakut dhe të trurit për shkak të arteriosklerozës. Përmban: kolagjen të hidrolizuar 200 mg, mikrokristalinë celulozë-115 mg,Vitaminë E-15 mg.
Përdorimi: 2 kapsula në ditë para ushqimit.

VAJ SALMONI (90 kapsula) Mban Diabetin nën kontroll - Forcon Zemrën - Kuron Artritin - Trajton Alergjitë - Ul Kolesterolin - Rrit Imunitetin - Parandalin Depresionin

Vaji i Salmonit është një burim i acideve yndyrore EPA omega-3 dhe DHA acide yndyrore poliunsaturated, yndyrna të cilat trupi nuk arrin ti sintetizoje vetë. Konsumi i Omega -3 është shumë i rëndësishëm për njerëzit që vuajnë nga diabeti dhe me probleme kardio- vaskulare. Mund të përdoret në trajtimin e artritit, alergjive, sëmundjeve të zemrës, për aktivitetet fizike intensive të atletëve, rritjen e imunitetit, për parandalimin e depresionit, për funksionimin dhe zhvillimin e trurit në mënyrë të duhur, gjithashtu ul kolesterolin. Përmban: vaj salmoni 500 mg,Vitaminë E natyrale 5 mg. Përdorimi: 3 kapsula në ditë para ushqimit.
Të mos përdoret nga fëmijët nën moshën 3 vjeç.

L-CARNITINE 300mg (60 kapsula) Djeg Yndyrnat - Forcon Zemrën - Trajton Kancerin - Mbron Mëlcinë - Kuron sëmundjen Celiak - Antioksidant i Fuqishëm

L-Carnitina është sot një prej shtesave ushqimore më të njohura, e përdorur nga atletët, por sidomos në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve. Ky amino-acid sintetizohet në mëlçi dhe veshka nga lisina dhe mathionina, dy amino- acide esenciale për shëndetin. Është gjetur kryesisht tek bimët si soja.Veç rëndësisë së tij si një djegës yndyre, L-cernitina është e dobishme në rritjen e shëndetit të zemrës dhe trajtimin e shumë sëmundjeve të kancerit. Ka aftësinë të mbrojë mëlçinë dhe dhe nervat periferike, është e dobishme në sëmundjet celiac, është efektive edhe në rastin e kancerit të gjirit, mund të zvogëlojë madhësinë e tumorit dhe ka efekte antioksidative shumë të forta. Ndihmon në sëmundjet kardiovaskulare, sëmundje ishemike të zemrës, shërim nga infarkti miokardik. Nuk lejohet të përdoret nën moshën 12 vjeç, gjatë shtatëzanisë dhe ushqyerjes me gji tek femrat. Për njerëzit të cilët kanë problem me frymëmarrjen nevojitet keshilla e mjekut për ta përdorur. Përmban: L-carnitinë -300 mg. Përdorimi: 3 herë në ditë nga1 kapsulë.

PROPOLIS (30 kapsula) Rrit Qëndrueshmërinë - Eliminon Lodhjen -Rigjeneron Indet - Shëron Plagët - Shëron mishtrat e dhëmbëve - Antiviral- Anti-viral - Anti-inflamator

Propolisi është kompleks bimor në formë rrëshire, përbërje të ndryshme pëlhure, dylli, vajra esenciale, hekur, mikroelemente - bakër, zink, mangan, kobalt, plus polen, flavonoide, sekrecione të pështymës së gjëndrës së bletëve. Propolisi është përdorur si një bio-stimulator i cili rrit qëndrueshmërinë dhe eleminon lodhjen. Për shkak të vetive antivirale, anti-toksike dhe anti-inflamatore, propolis gjen shumë përdorim. Është një situmulues i mirë i rigjenerimit të indeve të dëmtuara, të çarave dhe sidomos djegieve. Është shumë e dobishëm në shërimin e plagëve dhe shenjave pas operacioneve. Propolis oral shëron mukozën dhe është e dobishme në ndalimin e gjakderdhjeve në mishrat e dhëmbëve. Është një antiseptik i fuqishëm. Përmban: Propolis pluhur -170 mg,Vitaminë B1-0.50 mg,Vita- minë B2-0.50mg, acid folik- 70µg,Vitaminë B6-0.50 mg,Vitaminë C-25 mg,Vitaminë B12-1 µg,Vitaminë C-25mg. Përdorimi: 3 kapsula në ditë.

GINKGO BILOBA (60 kapsula) - Lufton: Stresin - Migrenën - Alzhajmerin - Nxit Qarkullimin e Gjakut - Lufton Impotencën - Rregullon glukozën tek diabetikët

Përbërësit: Ginkgo Biloba, vitaminë B1, vitaminë B2, vitaminë B6, acid folik, vitaminë B12, niseshte misri.
Kjo bimë është përdorur në mjekësinë tradicionale kineze për më shumë se 500 vjet. Përbërësit aktiv në xhinko përmbajnë flavonoide, terpenoide dhe acide organike. Studiuesit argumentojnë se efekti i dobishëm është e lidhur me aftësitë e saj antioksidante. Ginkgo Biloba ndihmon në stimulimin e kujtesës, në trajtimin e humbjes se kujteses tek te moshuarit, rrit përqendrimin.Ajo gjithash- tu ka aftësinë për të reduktuar stresin, lufton impotencëm dhe ndihmon në funksionet njohëse, veçanërisht në rastet e Alzhaimer. Lufton migrenën dhe dhimbjet e forta të kokës. Gjithashtu nxit qarkullimin e gjakut dhe rregullon glukozën tek diabetikët. Lehtëson sindromën paramenstruale PMS. Një përfitim tjetër i rëndësishëm nga veprimi i Ginko për t'u theksuar është se përballon efektet e kimioterapisë. Përdorimi: 4 kapsula në ditë.

IMMUNOSAN (60 kapsula) Largon Baktere e Këqija- Largon Stresin - Rrit Imunitetin - Lufton Debulesën - Mbron zorrët nga të ftohtit - Lufton Infeksionet e Organizmit

Ky produkt përmban tri bakteret (Lactobacillus acidofilus, Enterococcus thermophilus dhe Lactobacillus rhamnosus) Të treja në sasi të njëjta dhe në total një kapsule ka të paktën 5 miliardë baktere të mira. Doza e rekomanduar ditore është 10 bilion baktere duke konsumuar produkte bulmeti.Avantazhi i Immunosan është se është stabël dhe merret më lehtë nëpërmjet kapsulave. Udhëzimet e përdordorimit:Për ftohje të intestinit të zorreve, rrit imunitetin. Largon bakteret e këqija nga trupi duke e bërë më rezistent ndaj infeksioneve. Largon stresin. Përdoret pas kurave me antibiotik dhe ftohje të zakonshme. Kur e keni tepruar me pijen, dhe keni imunitet të dobet dhe debulesë.
Përbërësit: Inuline, Lactobacillus acidophilus, Enterococcus thermofilus, Lactobacillus rhamnosus magnesium stearate.
Përdorimi: 2 kapsula në ditë para ose pas vakteve me një gotë ujë. Ju rekomandojmë 2 cikle në vit.

GOOD NIGHT (60 kapsula) Frocon zemrën-Antisklerotike-Lufton Ankthin -Zgjeron Arteriet - Lufton pagjumësinë - Qetëson sistemin nervor - Dhuron mirëqenie të përgjithshme

Përbërësit: Murriz pluhur, fara lulëkuqe, lule pasioni pluhur, niseshte misri, vitaminë B1, B2, B6, acid folik.
Material i kapsulës: xhelatinë e forte.Vetite e Bimeve: Murrizi-Acidet triterpenike zgjerojne arteriet ne pergjithesi dhe ato koronare ne vecanti. Fuqizojne muskulaturen e zemres. Aminopurinat rregullojne qarkullimin e gjakut. Perdoret si mjet antisklerotik. Fuqizon zemren e demtuar nga shqetesimet nervore, ne goditjet e forta nervore, ne veshtiresite e frymemarrjes, ne pagjumesi etj.Farat e Lulëkuqes- janë përdorur si një mjekim natyror kundër ankthit dhe stresit, dhe kanë një efekt qetësues dhe sedativ për sistemin nervor. Lule pasioni -përdoret për trajtimin e çrregullimeve të gjumit dhe historikisht në mjekësinë popullore për të trajtuar dhimb- jet, pagjumësinë në lidhje me krizat nervore dhe histeritë. Një gjumë i qetë nxit mirëqenien e përgjithshme. Përdorimi: 1 kapsulë në ditë në mbrëmje.

MULTIVITAMINA + MINERALE A-Z (60 kapsula) - Shtojnë Rruazat e Kuqe të Gjakut - Shtojnë Masën muskulare - Anti stress- Rrisin fuqinë mendore dhe fizike

Kapsulat përmbajnë të gjitha vitaminat e mundshme dhe të gjitha mineralet dhe mikro-mineralet e nevojshme për jetën.
Përmban vitaminat:A, C, D3, E, B1, B2, B3, B6, B12,Acidi folik, K1+ Mineralet: Kalcium, Magnez, Hekur, Zink, Baker, Selen, Mangan, Krom, Molibden.
Kapsulat shërbejnë:- për të shtuar rruazat e kuqe të gjakut (kundër anemisë),- për të rritur imunitetin - për të rritur fuqinë fizike dhe mendore
- për të shtuar masën muskulore dhe zvogëluar masën dhjamore në bark (kundër mbipeshës), - për të rritur koncetrimin, vëmendjen, logjikën, - për të larguar stresin, depresionin (e lehtë), dobësinë, ligështinë Kapsulat mund të merren edhe nga personat e shëndoshë (për kënaqësi, për të patur një jetë të shëndetshme) ndërsa janë pothuajse të domosdoshme për personat që merren me sport, fitness, punë fizike, për personat e sëmurë, me stres, për ushtarët, policët, rojet e sigurisë, për personat që rrinë shumë pa gjumë, etj Përdorimi: 2 kapsula në ditë.

BIO XHINXHER (60 kapsula) Lufton Artritin - Lufton Infeksionet - Anti-Kancer - Ul Kolesterolin - Mbron Zemrën - Shkrin Dhjamin -Afrodiziak i Fuqishëm

Xhinxheri është një lloj ilaçi tradicional indian i përdorur kundër dhimbjeve të artritit.
konsumimi i lartë i xhinxherit ndihmon për të reduktuar dhimbjet që shkaktojnë infeksionet. Xhinxheri i është një trajtim omeopatik për infeksione të ndryshme. Përdoret aktualisht në mjekësinë moderne për të trajtuar të përzierat që shkaktohen nga kimioterapia, madje edhe të përzierat në mëngjes gjatë shtatzënisë. Xhinxheri mund të ndihmojë në luftën kundër sëmundjeve të zemrës dhe uljen e kolesterolit. Ai shkrin ydnyrnat në organizem duke ndihmuar rënien nga pesha në një kohë më të shpejtë. Në mjekësine arabe është konsideruar afrodiziak pasi shton deshirën seksuale. Përbërësit: 100% Xhinxher Organik. Materiali i kaspulës: xhelatinë e fortë. Përdorimi: 2 kapsula në ditë.

BIO SPIRULINA 400mg (60 kapsula) Pastron zorrët - Shkrin Yndyrën - Trajton Aneminë - Trajton Diabetin - Anti-Kancer - Forcon Imunitetin - Forcon Muskujt

Shtesë ushqimore ekologjikisht e pastër.
Spirulina përmban rreth 50 nutrientë bioaktivë të cilat përfshijnë rregullimin e funksioneve të trupit. Spirulina (spirulina platensis) përmban nje kombinim të fuqishëm të substancave esenciale për trupin e njeriut, disa shumë të rralla dhe të rendësishme. Spirulina është lehtësisht e tretshme, normalizon mikroflorën e zorrëve, pastron trupin, dhe siguron rënie nga pesha në mënyrë natyrale që rezulton si pasojë e shkëmbimt të përmbajtjes së substancave toksike në kyçe, muskuj dhe limfë. Forcon muskujt, përmirëson shikimin, forcon flokët, elasticitetin e lekurës, normalizon nivelin e kolesterolit, forcon sistemin nervor , parandalon dhe trajton arteriosklerozen, rregullon presionin e gjakut, trajton aneminë, hepatitin, gastritin, diabetin, hipogliceminë dhe përmirëson imunitetin. Përmban: 100% Spirulina Organike. Përdorimi: 3 kapsula në ditë për një përiudhe 3-6 muaj.

USHQIMET
Produkte e Reja
tek Dyqanet Neranxi

NERANXI 1991

PRODUKT I RI

REISHI Ling Zhi

Kërpudha e Pavdekësisë

Kërpudha Reishi, quhet ndryshe (Lingzhi), është një kërpudhë e cila përshkruhet si "e ashpër" dhe e "drunjtë" me një shije të hidhur. Trupi i frutit (mbi tokë) dhe pjesa e micelit (filamentet e lidhura me një grup kërpudhash) janë përdorur si ilaç.

Kërpudha Reishi përdoret për forcimin e sistemit imunitar, dhe parandaluar infeksionet virale të tilla si: gripi, gripi i derrit, dhe gripi i shpendëve, problemet e mushkërive duke përfshirë astmën dhe bronkitin, sëmundjet e zemrës dhe duke kontribuar për mire në gjëndje të tilla si: tensioni i lartë i gjakut dhe kolesteroli i lartë, sëmundjet e veshkave, kanceri dhe sëmundjet e mëlçisë.

Ajo është përdorur edhe për HIV / AIDS, sindromën e lodhjes kronike (CFS), probleme me pagjumësinë, ulcerat në stomak, helmimet dhe herpes.

Përdorime të tjera përfshijnë: reduktimin e stresit dhe parandalimin e lodhjes. Ndryshe nga kërpudha e tjera, Reishi përmban acid ganoderik, e cila i jep një shije të butë të hidhur.Ajo ka efekte anti-inflamator dhe anti-kancerogjen.

Reishi gjithashtu përmban PS-G polysaccharides, të cilat forcojnë sistemin imunitar, pengojnë proceset e vdekjes qelizore dhe veprojnë si antioksidantë. Gjithashtu përmban proteina dhe një përqindje të lartë të fibrave dietike, që rregullojnë tretjen dhe përshpejtojnë detoksifikimin nga toksinat e dëmshme.

Reishi gjithashtu përmban minerale si: fosfor, kalcium, magnez, kalium, natrium, zink, mangan, hekur dhe bakër.

Disa substanca të tjera bioactive gjithashtu të pranishme në pluhur Reishi janë edhe: ergosteroli, mannitoli, kumarini, alkaloidet, laktonet, acidet yndyrore të pangopura dhe adenosinet. Së bashku, ata ndihmojnë për të përmirësuar mirëqenien e përgjithshme dhe për të rritur fuqinë fizike.

Pëdorimi: Këshillohen të merret 5.2 gr çdo ditë.

LAMTUMIRË KAPSLLËK!

ZGJIDHJA ËSHTË LËVORJA PSYLLIUM

PRODUKT I RI

Lëvorja Psyllium e njohur gjithashtu si Ispaghula, Isabgol ose Psyllium, ësshtë pjesë e farave të bimës Plantago Ovata,është vendase në Indi dhe Iran, dhe në mjekësinë tradicionale zakonisht janë përdorur farat e bimës. Në Perëndim, shumica e njerëzve përdorin suplemente të bëra nga lëvorja Psyllium, një burim i pasur i fibrave të tretshme që lehtësojnë kapsllëkun dhe ulin kolesterolin. E pasur me fibra të tretshme ajo nuk përbën rrezik për organizmin, gjithsesi para se të përdorni lëvoren Psyllium këshillohuni me mjekun lidhur me dozën e duhur të cilën duhet të merrni.

Doza e përgjithshme: Doza e saktë varet nga arsyeja e përdorimit të saj. Qendra Mjekësore në Universitetin e Pitsburgut raporton një dozë për të rriturit 3-6 gr, dy deri tre herë në ditë, por në disa kushte të veçanta mund të kërkohen doza më të larta. Fëmijët mund të marrin gjysmën e dozës së sugjeruar, e cila arrin deri në 9 gr në ditë gjithsej, gjithmonë konsultohuni me pediatrin tuaj para se tia jepni fëmijëve.

Doza për kolesterolin e lartë: Një analizë e dalë nga tetë studime, e botuar në numrin e shkurtit të vitit 2000 në "The American Journal of Clinical Nutrition", shqyrtoi efektet e lëvorës Psyllium tek kolesteroli dhe u gjet se një dozë prej 10.2 gr në ditë ulte kolesterolin e keq (LDL), me rreth 7 %, kur kombinohej me një dietë të ulët në yndyrë. Një meta-analizë e 21 studimeve, e botuar në numrin e korrikut në "European Journal of Clinical Nutrition", të vitin 2009 u zbulua se doza mes 3 g dhe 20.4 g ulte kolesterolin. Efekti ishte në proporcion të drejtë me dozat e përdorura. Nëse dëshironi të merrni Psyllium për të trajtuar kolesterolin e lartë, flisni me mjekun tuaj në lidhje me dozën e duhur.

Doza për probleme të tjera shëndetësore: Universiteti i Sistemit Shëndetësor ne Michigan, raporton se nga kërkimet dhe mjekët përdorin dozat e mëposhtme ditore:

Për kapsllëk: 5 gr një deri dy herë në ditë.

Sëmundjet divertikulare (një gjendje në të cilën spazma e muskujve në zorrën e trashë në praninë e divertikulave shkakton dhimbje barku dhe çrregullime të funksionit të zorrëve, pa inflamacion) rekomandohet: 7 gr.

Sindroma zorrëve të irrituara: 3.25 gr, tre herë në ditë

Diabeti: 5.1 gr, tre herë në ditë me ushqim

Diarrea: 9 – 30 gr në ditë.

Hemorroidet: 7 gr tre herë në ditë

Trigliceridet e larta: 15 gr

Pini të paktën 280 ml ujë në çdo dozë të marrë dhe shumë lëngje gjatë ditës për të parandaluar kapsllëkun. Nëse konsumi i juaj në fibra ka qënë i ulët deri tani, niseni me sasi të vogla për të lejuar trupin të rregullojë dhe reduktojë efektet anësore si gazrat dhe fryrjet abdominale. Shmangeni përdorimin e Psyllium në qoftë se ju keni bllokim të zorrëve, probleme në gëlltitje, dhimbje të pashpjegueshme barku ose gjakderdhje të zorrës së trashë.

USHQIMET
Produkte e Reja
tek Dyqanet Neranxi

NERANXI 1991

KINOA E BARDHË

KINOA E ZEZË

KINOA E KUQE

{Chenopodium quinoa}

KINOA, SUPER DRITHI I SË ARDHMES

Organizata e Ushqimit dhe e Bujqësisë FAO (Food and Agricultural Organization of the United Nations) deklaroi vitin 2013 si 'Viti ndërkombetar i Kiona-s', duke e klasifikuar Kinoan si të vetmin ushqyes bimor që përmban të gjithë aminoacidet esenciale, oligoelementët dhe vitaminat pa patur gluten. Kinoa e zezë dhe e kuqe pas gatimit e ruan më mirë formën se sa kinoa e bardhë. Dhe koha e gatimit është 2-3 minuta më shumë se kinoa e bardhë. Vlerat ushqyese janë po të njëjta me Kinoan e bardhë apo si quhet ndryshe Kinoa e Fildishtë, me ndryshimin se përqindja e agjentëve ushqyes dhe antioksidantëve është më e larte te Kinoa e Kuqe dhe akoma më e lartë tek Kinoa e Zezë. Kinoa është lloj 'fare' që konsumohet në të njëjtën mënyre si drithërat (gruri, tërshëra) por nuk bën aspak pjesë në këtë grup. 'Chenopodium Quinoa' është emri shkencor por quhet 'pseudo-drithër' duke qenë se përdoret si e tillë, mund të shndërrohet lehtësisht në miell edhe pse është pjesë e së njëjtës familje si spinaqi dhe panxhari. Nëse e krahasojmë me pjesën më të madhe të drithërave, përmban më shumë proteina, ndër të cilat përmendim amicoacidin lisine dhe isoleucine. Përmban gjithashtu yndyrë, pjesa me e madhe jo e saturuar si acide yndyrore Omega-6 dhe Omega-3. Përsa i përket kalorive përmban më pak hidrate se drithërat dhe fibra jo të tretshme duke e klasifikuar në ushqimet me indeks glicemik të ulët dhe me veti të larta detoksifikuese. Përmban minerale si kalium, manganez, magnez, kalcium, fosfor, hekur, zink dhe ofron vitamina të grupit B dhe vitamina E me funskione të larta antioksiduese. Me të gjitha vlerat e përmendura më sipër, Kinoa është ushqim ideal për një dietë të shëndetshme dhe te ekuilibruar dhe gjithashtu në raste të semundjes celiake, probleme te ndryshme të trejtes, të obezitetit, të diabetit, të kolesterolit dhe sëmundjeve kardio-vaskulare. Fito-nutrientet antioksidantë (vecanërisht dy flavonoidet quercitin dhe kaempferol) dhe fito-nutrientët anti-inflamatore (acide fenolike duke përfshirë acidet hidrocinamike dhe hidroksibenzoike) të gjendur në të e bëjnë të jetë një ushqim që ndihmon në uljen e rrezikut të sëmundjes së kancerit. Ka vetëm 172 kalori për 1⁄4 e një filxhani me Kinoa të tharë. Eshtë pa gluten. Miliona njerëz kane zbuluar se ndihen më mire dhe kanë humbur peshë ndërkohë ata reduktojnë dhe produktet me bazë gruri. Është një karbohidrat kompleks me indeks të ulet glicemik. Dhe njëkohësisht është shumë e mirë për menaxhimin e peshës.

Këshilla për gatimin dhe ngrënien e Kinoas:

• Gjithmonë Kinoan shplajeni me ujë.Vendosni Kinoan në një enë kulluese në ujë të ftohtë dhe rrjedhshëm derisa e gjitha lënda shkumëzuese(që quhet saponinë) të jetë shplarë (zhdukur).• Kinoa mund të përdoret në sallatë ose mund ta zjeni në ujë deri sa të zbutet(si trahana). Gjithashtu Kinoa pudding zëvendëson më së miri orizin dhe miellin e zakonshëm. (Sultiash kuinoe) • Me Kinoa mund edhe të bësh popcorn (në vend të misrit) shumë e përdorur për femijët në Peru.• Është e kështillueshme që Kinoa të mbahet në një enë të mbyllur (e gatuar); në frigorifer, do të zgjase 4 deri në 6 muaj. Në gjendje të thatë ka afat 2-3 vjet.

Produkte për Bare TOSCHI

Kompania Toschi është themeluar në vitin 1945 në Vignola (Modena) Itali, kur Giancarlo dhe Lanfranco Toschi zhytën për herë të parë qershitë e famshme Vignola në alkool për ti ruajtur dhe shijuar ato gjatë gjithë vitit.

Gjatë 70 viteve të saj në këtë biznes, kompania ka zgjeruar jashtëzakonisht gamën e produkteve; tani ato shkojnë nga frutat në alkool tek likerët si (Fragolì, Mirtillì, Nocino, Nocello, Lemoncello, Amaretto), nga shurupe për kokteile dhe long drinks deri tek toppings dhe Aceto Balsamico e Modenas IGP (PGI, tregues i mbrojtur gjeografikisht).

Misioni i Toschi Vignola është që të ofrojë produkte të cilësisë në treg, në të njëjtën kohë duke respektuar traditën dhe veçoritë territoriale. Certifikimi i cilësisë: Në vitin 2000 Toschi Vignola mori certifikimin UNI-EN-ISO 9001: 2000. Në vitin 2006 ajo mori certifikimin IFS për të gjitha produktet e saj.

Kompania Neranxi prej 12 vjetësh është distributor eksluziv i Kompanise italiane Toschi.

Një barist profesionist mund të zgjedhë lirisht në këtë gamë të gjerë produktesh, për t'iu ofruar klientëve koktejle shumë të veçanta, por edhe shtëpiaket mund të zbulojnë falë "Toschit" disa aftësi në përgatitje koktejlesh, që do të befasohen edhe vetë.

Produktet Toschi i gjeni tek Kompania Neranxi për profesionistët, dhe në rrjetin e dyqaneve Neranxi për familjarët.

Shurupe pë r Bare Toschi në paketim mini, 250 ml

Ammos

Potam - Himarë, Albania
+355 69 70 27 890
ammoshimare@gmail.com
ammos
ammos_himare

BEACH BAR • RESTAURANT • BED & BREAKFAST

Studentët e Institutit Kulinar Neranxi të pranishëm në çeljen e sezonit të ri Turistik, në Sarandë dhe Ksamil

SEZONI I RI
TURISTIK
Sarande -Ksamil 2016

Saranda ka festuar në datat 3 dhe 4 Qershor 2016, Festën e Midhjes e cila po shndërrohet në një traditë të këtij vendjo tashmë. Aktiviteti është organizuar nga Bashkia e Sarandës e cila, është promotore e promovimit të midhjes si një produkt të rrallë ujor që rritet në Liqenin e Butrintit dhe që konsiderohet nga vendasit, si perla e Sarandës. Për herë të parë, çelja e sezonit është bërë në Ksamil dhe Kompania Neranxi dhe Instituti Kulinar Neranxi, kanë preferuar të kenë një pjesmarrje masive, me shumë specialistë të Kompanisë, si profesorë dhe studentë të shkollës së Kulinarisë Neranxi.

Si gjithmonë të gatshëm për të kontribuar në promovimin e kuzhinës dhe turizmit shqiptar, studentët e Institutit Kulinar Neranxi, kanë filluar tashmë të gatuajnë për turistët dhe vizitorët shqiptarë dhe të huaj të cilët janë të shumtë.

Vizitorët kanë mundësi të degustojnë recetat më bazë midhjen, frutat dhe prodhime të ndryshme deti, të shoqëruara me salcat dhe erëzat e mrekullueshme të Kompanisë Neranxi. Nuk do të mungojnë pizzat, krepat, waffles, kokteilet granitat, patatinat meksikane dhe sigurisht akulloret fantastike artizanale italiane. I pyetur për këtë aktivitet dhe për aktivitetin në përgjithësi të gjithë bizneseve me markën Neranxi, presidenti i tyre Nikollaq Neranxi shprehet: "Edhe pse është një situatë jo e mirë ekonomike në vend, ne vendosëm të investojmë për një aktivitet të tillë, si një kontribut për turizimin shqiptar dhe për imazhin e mirë të këtij vendi- u shpreh Nikollaq Neranxi.

KORRIERI i SHËNDETIT

Këshilla nga nutricionisti

i Institutit Kulinar Neranxi,
Dr. N. Neranxi

Flora bakteriale dhe aktiviteti metabolik i saj

"Flora e zorrëve është e kundërt me mëlçinë: ndërsa kjo e fundit kryen një numër të lartë të reaksioneve kimike oksiduese, flora kryen reduktime, duke çliruar metan, hidrogjen dhe amoniak dhe duke transformuar në mënyre fondamentale përmbajtjen e zorrëve."

Mikroorganizmat e zorrëve formojnë një ekosistem shumë kompleks. Popullatat mikrobike shtohet (rritet) nga stomaku drejt pjesëve fundore të zorrëve dhe arrijnë maksimumin e tyrë në zorrën e trashë. Tipi i të ushqyerit është i rëndësishëm në ruajtjen e florës bakteriale, por nuk është gjithçka e qartë se cili mund të jetë ndikimi i të ushqyerit mbi popullatën mikrobike. Personat që konsumojnë pak mish dhe shumë karbohidrate do të kenë një florë bakteriale më të zhvilluar. Në florën bakteriale mbizotërojnë mikroorganizmat anaerobe dhe, nga ana biokimike, proceset fermentative. Aktivitetet e tyre metabolike janë të shumta. Flora është e kundërt me mëlçinë: ndërsa kjo e fundit kryen një numër të lartë të reaksioneve kimike oksiduese, flora kryen reduktime, duke çliruar metan, hidrogjen dhe amoniak dhe duke transformuar në mënyrë fondamentale përmbajtjen e zorrëve.

Shumë tipe të ndryshme të reaksioneve mund të kryhen nga mikroorganizmat e strehuara në zorrët..

Një pjesë e amidonit dhe karbohidrateve të tjera, si dhe celuloza, që nuk treten në zorrën e hollë, shpërbehen nga flora bakteriale dhe fermentuese, me prodhimin e acideve yndyrore me varg të shkurtër. Polisakaridet komplekse që ndërtojnë fibrat mund të jenë objekt i veprimit të florës bakteriale.

Shumë amina dezaminohen dhe ureja shpërbehet nga ureaza në amoniak dhe anhidrid karbonik. Bakteret janë akoma të afta të formojnë amide. Një shembull klasik është formimi i N-acetilhistaminës. Flora bakteriale mund të formojë nitrozeamina, që kanë aktivitet kancerogjen.

Flora bakteriale mund të veproje edhe mbi shumë steroide, sikurse kripërat biliare. Të sintetizuara në mëlçi dhe të sekretuara në bilën, janë acidet kolanik të zevendësuar dhe të konjuguar (lidhur) me glicinën dhe taurinën. Ato pësojnë një cikël aktiv enteropatik dhe vetëm rreth 5% eliminohet me feçet në çdo cikël. Flora bakteriale ka një rol të rëndesishëm në metabolizmin e këtyre komponimeve.

Kolesteroli përthithet pjesërisht në zorrë dhe mund të modifikohet nga flora bakteriale. Metabolitet kryesore janë koprostanoli dhe koprostanoni.Koprostanoli paraqet rreth gjysmën e steroleve neutrale fekale, ndërsa koprostanoni rreth 10-15%. Mbetja është kolesteroli i pamodifikuar.

Ndër aktivitetet e florës bakteriale, duhet të përmendet formimi i vitaminave. Vitamina K sintetizohet dhe përthithet në zorrët. Nevoitet të kuptohet që administrimi i antibiotikëve që mund të shkatërrojnë florën bakteriale (si neomicina) mund të çojë në alterime të koagulimit të gjakut, nëqoftese vitamina nuk është e pranishme në sasi adekuate në ushqimet.

Edhe vitamina B12 mund të sintetizohet nga flora bakteriale, por humbet me feçet. Ne fakt, biosinteza e saj kryhet në zorrën e trashë, por përthithet në zorrën e hollë. E ndryshme është situata në ruminantet, të afta të përthithin vitaminën B12 të formuar nga flora bakteriale gastrike. Për këtë mishi dhe qumështi i këtyre kafshëve janë ndër burimet e vit. B12 më të rëndësishme në të ushqyerit e njeriut.

Biotina sintetizohet nga flora bakteriale, por ecuria është analoge me atë të vit.B12, kështu që kontributi i florës bakteriale në të ushqyerit biotinik mungon.

Disa vitamina të grupit B mund të sintetizohen nga flora bakteriale, si folati dhe tiamina, por, për një aresye ose një tjetër, kjo sintezë nuk është e mjaftueshme të mbulojë nevojat..

Disa proteina nuk mund të përdoren, sepse vijnë nga sekrecionet ose luspimi i qelizave të epitelit të zorrëve. Këto mund të konsumohen nga flora bakteriale, që ndër të tjera, është e aftë të fermentojë aminoacidet, duke filluar me reaksionet e dekarboksilimit ose të dezaminimit. Kështu, formohen amina dhe acide yndyrore me varg te shkurtër, pastaj përthithen.

Shume amina të prodhuara kështu (ose të futura si të tilla me ushqimin) kanë efekte mbi sistemin nervor, por metabolizohen nga mëlçia. Në rastin e difekteve hepatike të rënda, ato nuk detoksilohen dhe mund të manifestojnë efektet e tyre të dëmshme.

Ruminantet, të afte të përdorin për qëllime energjitike fibrat ushqimore, përthithin kryesisht acidet yndyrore me varg të shkurtër, si acetik, propionik dhe butirik, të prodhuara nga fermentimi në zorrë i celulozës dhe komponente të tjera të fibrave. Acide të tjera yndyrore me varg të shkurtër, si formik, valerik, kaproik dhe me varg të degëzuar si izobutirik dhe izovalerik, prodhohen në sasi të vogla.

Pigmentet biliare sekretohen si bilirubinë të lidhur me acidin glukuronik. Flora bakteriale çon në një dekonjugim të kësaj përbërjeje. Bilirubina reduktohet pastaj në bilinogjen, që mund të përthithet dhe eliminohet me urinën.

USHQIME TË MIRA PËR TRETJEN DHE ZORRËT:

1- LIMONE
2- FARA KIA
3- FARAT E LINIT
4- FARAT E KUNGULLIT
5- HUDHRA
6- ARRA E KOKOSIT
7- PESHKU
8- PERIMET
9- TËRSHËRA
10- XHINXHER
11- LEGUMINOZET

INSTITUTI KULINAR NERANXI

QENDRA SHQIPTARE PROFESIONALE E GATIMIT

Mësoj për Shqipërinë!

Filluan regjistrimet për vitin e ri shkollor 2016-2017,
shkollë dy-vjecare për shef kuzhine dhe shef pasticerie
si dhe kurse 1-9 mujore për degët:

- **Kuzhinë**
- **Pasticeri**
- **Xhelateri**
- **Bukëpjekës**
- **Picajol**
- **Barman**
- **Kamarier**
- **Menaxhim hoteli**

Zgjidhni profesionet e bukura
të artit të kulinarisë

Ju mirëpresim!

Instituti Kulinar Neranxi

Kontakt

Adresa: Autostrada: Tiranë- Durrës, Km 7, Yrshek, Tel: +355 42 406 500/ 501;
+355 4 240 66 36; Cel: +355 68 60 40 205; e-mail: info@ikn.al; www.ikn.al